

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-022/12**

**Prishtinë  
29 nëntor 2012**

Në çështjen juridike të:

**I.K**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese*

Kundër

**D.N**

*Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit i Kërkesave Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011 (lëndët e regjistruara në AKP me numrint KPA15539, KPA15540, KPA15541, KPA15542 dhe KPA15543), të datës 07 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 29 nëntor 2012, morri këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Lëndët GSK-KPA-A-22/12 deri GSK-KPA-A-26/12 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numër GSK-KPA-A-22/12.
- 2- Hedhet si e palejueshme ankesa I.K e ushtruar kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011 (lëndët e regjistruara me numrat: KPA15539, KPA15540, KPA15541, KPA15542 dhe KPA15543), i datës 7 shtator 2011.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 37,50 € (tridhjetë e shtatë presje pesë), të cilat duhet të paguhet në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 10 tetor 2006, D.N ka paraqitur pesë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore në disa ngastra dhe riposedimin e tyre. Ajo ka shpjeguar se prona e saj është humbur si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë dhe se data e humbjes është 12 qershor 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur dokumentet në vijim:

- Fletën Poseduese Nr. 26 e lëshuar nga Drejtorja e Gjeodezisë e Komunës së Pejës, e datës 26 gusht 1984;
- Kopjen e Planit të lëshuar nga Drejtorja e Gjeodezisë e Komunës së Pejës, e datës 9 janar 1985;
- Çertifikatën e lindjes së D.N, e lëshuar me 26 nëntor 2004;
- Aktvendimin e Trashigimisë lëshuar nga Gjykata Komunale e Pejës T.nr....., i datës .....
- Fletën Poseduese Nr. 26, e lëshuar me 26 gusht 2008 nga Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Pejës.

Të gjitha këtë dokumente kanë mundur të verifikohen nga ekipi verifikues i AKP-ës.

- Në bazë të Fletës Poseduese Nr. 26, e datës 26 gusht 2008, e lëshuar nga nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Pejës, në emër të paraqitëses së kërkesës janë regjistruar këto prona:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-22/12 (KPA15539)	ngastrat nr. 440, në vendin e quajtur “Kuçanska Mala”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0. 43. 50 ha;
GSK-KPA-A-23/12 (KPA15540)	ngastrat nr. 441, në vendin e quajtur “Kuçanska Mala”, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0. 14. 57 ha;
GSK-KPA-A-24/12 (KP15543)	ngastrat nr. 443/2, në vendin e quajtur “Kuçanska Mala”, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0. 24. 35 ha;
GSK-KPA-A-25/12 (KPA15542)	ngastrat nr. 443/1, në vendin e quajtur “Kuçanska Mala”, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0. 18. 96 ha;
GSK-KPA-A-26/12 (KPA15541)	ngastrat nr. 442, në vendin e quajtur “Kuçanska Mala”, shtëpi, me sipërfaqe prej 0. 00. 72 ha.

Gjatë procedurës, vajza e paraqitëses së kërkesës, V.B, pas kontaktimit nga Sekretaria Ekzekutive me 15 shkurt, 23 qershor, dhe 29 korrik 2010 konfirmoi se pronat e kërkuara të përfshira në Fletën Poseduese Nr. 26, me përjashtim të ngastrës Nr. 428/8 i janë shitur B.K në vitin 1979, dhe se ai i kishte përmbushur të gjitha obligimet sipas kontratës së shitblerjes. Më tutje, ajo thekson se kërkesat janë paraqitur për shkak se nëna e saj nuk ka pasë dijeni të saktë se cilat parcela i ishin shitur Binak Kuçit, i cili është babai i ankuesit në këtë kërkesë. Më tej, ajo pohon se këto prona nuk ishin humbur për shkak të rrethanave të lidhura drejtëpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur i vitit 1998/1999 në Kosovë. Pas shitjes së këtyre pronave, të dytë babai dhe nëna e saj ishin vendosur në Pejë.

Gjatë njoftimit të kërkesës, prona e kërkuar ishte gjetur si e uzurpuar nga I.K, i cili kishte kërkuar të drejtat ligjore të pretenduara. Më tutje ai theksoi se palujtshmëritë e kërkuara i ishin shitur B.K në vitin 1979 dhe se paraqitësi i kërkesës kishte pranuar të gjithë çmimin shitëblerës. Ai, pala përgjegjëse në kërkesë, ishte në posedim të këtyre palujtshmërive që nga viti 1979, paraqitësja e kërkesës së

bashku me bashkësjhortin e saj kishin jetuar në Pejë që nga ajo kohë. Ai thekson gjithashtu faktin se ai kishte paraqitur një padi para Gjykatës Komunale në Pejë për vërtetimin e të drejtës pronësore.

Pala përgjegjëse në kërkesë me qëllim të mbështetjes së pretendimeve të tija si bartës i së drejtës pronësore kishte paraqitur këto dokumente ose dëshmi relevante ligjore :

- procesverbalin e seancës gjyqësore, C.nr.139/5, i datës 18 mars 1988; në procesverbal paraqitësja e kërkesës pohon faktin se në vitin 1979 B.K ia ka shitur ngastrën Nr. 438/8 si dhe tri hektar pronë të paluajtshme private;
- deklaratën me shkrim të A.A, zyrtar pranë Drejtorisë së Financave në Pejë, nr. 3828, datë 12 qershor 2009, sipas së cilës pala përgjegjëse në kërkesë kishte paguar tatimet në pronat e kërkuara.

Të gjitha këto dokumente nga Ekipi Verifikues i AKP-ës janë verifikuar pozitivisht në organet kompetente, të cilat edhe i kanë lëshuar ato dokumente apo të njejtat janë depozituar apo arhivuar sipas detyrës zyrtare.

Me 07 shtator 2011, KKPK-ja në vendimin e tij KPCC/D/R/120/2011 e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka konkluduar duke qen se V.N, vajza e paraqitëses së kërkesës ka pohuar faktin se në vitin 1979 pronat e kërkuara i janë shitur palës përgjegjëse, prandaj edhe ajo nuk ka paraqitur prova juridikisht të vlefshme për të vërtetuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar.

Vendimi i është dërguar palës përgjegjëse në kërkesë me 4 janar 2012. Me 10 janar 2012, pala përgjegjëse në kërkesë (mëtuftje: ankuesi) ne secilin lëndë ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Ai ka gjetur se vendimi gabimisht nuk përmend asnjë nga parcelat me numrat. 440, 441, 442, 443 dhe 444/2 [me sa duket ky numër është një gabim meqë si i tillë nuk ndodhet në vendimin e ankimuar]. Ai deklaron se Gjykata Komunale e Pejës deri më tani nuk ka caktuar sencë gjyqësore dhe ka thënë se e drejta e tij e pronësisë është konfirmuar.

### **Arsyetim ligjor:**

### **Bashkimi i lëndëve:**

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira,

kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile, të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha ankesave nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të ushtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të pesë lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

Lëndët e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-22/12, GSK-KPA-A-23/12, GSK-KPA-A-24/12, GSK-KPA-A-25/12 dhe GSK-KPA-A-26/12 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-22/12.

### **Pranueshmëria e ankesës:**

Ankesa është e palejueshme.

Ankuesi nuk ka të drejtë në ankesë. E drejta e ankesës ju takon atyre – dhe vetëm atyre – personave, të cilët vendimi i kontestuar ka shkaktuar pasoja negative. Sidoqoftë, vendimi i kontestuar i KKPK-ës, nuk ka pasur efekte negative ligjore në ankuesin. Përkundrazi, me vendimin e tij KKPK-ja ka hedhë kërkesën e D.N. KKPK-ja nuk ka vendosur në asnjë kërkesë të paraqitësit të kërkesësmeqë kjo nuk ka qenë pjesë e jurisdikcionit të KKPK-ës. KKPK-ja vendosur vetëm në kërkesat me të cilat paraqitësi i kërkesës thekson se ai/ajo ka humbur pronën për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999 në Kosovë. Pala përgjegjëse në kërkesë asnjëherë nuk kishte paraqitur kërkesë formale e cila do të duhej dorëzuar der në fundin e vitit 2007 (Neni 8 i Udhëzimit Administrativ 2007/5 i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079) sikur që nuk kishte thënë asnjëherë se kishte humbur pronën për shkak të rrethanave që rrjedhin direkt nga konflikti i armatosur (Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut

2006/50 i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Në të pesë rastet ankuesi ka vepruar vetëm si palë përgjegjëse në kërkesë. KKPK-ja në përputhshmëri me dispozitat ligjore nuk ka mund të vërtetoj të drejtën e pronësisë, KKPK-ës i është dashur të vendos nëse do të vërtetoj të drejtën e pronësisë së paraqitësit të kërkesës, D.N, dhe ka vendosur të mos e bëjë këtë. Prandaj, meqë vendimi nuk ka pasur ndonjë efekt ligjor negativ në ankuesin, ankuesi nuk ka të drejtë ankese në këtë vendim.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.12, 10.1 dhe 10.15 përshtatshëmrisht të UA 2008/2), duke pasur parasysh vlerën e palujtshëmrisë në këtë rast mund të vlerësohet deri në € 700: € 7,50 (gjysma e taksës nga tarifa gjyqësore sipas taksës nga tarifa gjyqësore numër 10.1 e cila do të ishte € 15).

Këto taksa nga tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin.

Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 ditë. Neni 47.3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme .

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**